



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

RAPORTIMI VJETOR

në

KOMISIONIN PARLAMENTAR TË EKONOMISË-11 MARS 2011

PËRMBLEDHJE

PJESA I: Vështrim i shkurtër mbi tregjet e mbikëqyrura – 2010

PJESA II: Analizë e veprimitarisë së AMF-së në v. 2010

Rregullimi

Integrimi Evropian

Mbikëqyrja

Masat

PJESA III: Bashkëpunimi

PJESA IV: Kapacitetet institucionale

FOKUSI PËR V. 2011

Të nderuar deputetë,

Me privilegjin dhe përgjegjësinë që më jepet, raportoj sot para jush aktivitetin dhe sfidat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2010.

Raporti vjetor në dispozicion, është një renditje e veprimtarisë së AMF-së për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe angazhimeve të institucionit, si dhe pasqyrë e zhvillimeve të tregjeve financiare jo-bankare, kryesisht atij të sigurimeve. Raporti përmban një sërë analizash, treguesish dhe të dhënash informative, ndërsa në këtë prezantim synoj të evidentoj veprimtaritë dhe çështjet më thelbësore.

Të nderuar deputetë,

- Edhe gjatë viti 2010, veprimtaria e AMF-së është udhëhequr nga misioni i saj themelor, që është, **mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe publikut në tërësi**, e lidhur ngushtë me **stabilitetin financiar të operatorëve të mbikëqyrur**.

Të nderuar deputetë,

Me kënaqësi ju raportoj, se në vijim të punës së nisur prej 3 vjetësh, gjatë vitit 2010, AMF ka bërë një punë intensive në drejtim të prezantimit të metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun. Përgatitja e kësaj metodologjie konsiston në një paketë me tre elemente kryesore:

- Manualët e mbikëqyrjes on dhe off site,
- Kuadri ligjor, projektligji i sigurimeve dhe risigurimit me aktet nënligjore, që sigurojnë zbatimin, si dhe
- ngritja e një platforme moderne teknologjie-informacioni për raportimin e procesimin e të dhënave të tregut në Autoritet.

Të tre këto komponentë, në sajë të një angazhimi të madh profesional dhe asistence, janë projektuar dhe këtë vit po testohen e pritet të finalizohen si produkte.

Si një metodologji me një filozofi të re, është punuar shumë për trajnimin e stafit, është bashkëpunuar ngushtë me tregun sipas një programi afat mesëm për zbatimin e tij.

Në gjithë këtë proces, Autoriteti ka ndjekur me kujdes zhvillimet mjaft dinamike mbi rolin e rregullatorit financiar, të diktuar nga reflektimi i krizës financiare botërore, në përshtatje me stadin e tregut vendas.

Shënim:

Raporti i depozituar në Kuvend, në muajin shkurt 2010, për pjesën e analizës financiare, është bazuar në masë të madhe në të dhënat e tregut për 9 mujorin e vitit 2010, ndërsa të dhënat statistikore i përkasin periudhës janar-dhjetor 2010, pas përpunimit të të dhënave përkatëse operative të raportuara nga shoqëritë.

Disa nga zhvillimet kryesore dhe karakteristikat e tregjeve të mbikëqyrura:

Po filloj me tregun e pensioneve vullnetare, megjithëse ai është akoma shumë i vogël, si nga numri, ashtu dhe vlera e kontributeve. Në vitin 2010 u dha licenca e parë e shoqërisë administruese të fondeve dhe e fondit të parë të pensioneve vullnetare, sipas standardeve evropiane dhe kjo ndodhi menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar”. Ky ligj bëri të mundur përshtatjen me standardet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane për fondet private të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara por dhe aktivizimin e tregut. Ligji i pensioneve përmban lehtësira fiskale për kontribuesin, të cilat falë mbështetjes tuaj janë reflektuar dhe në aktet ligjore tatimore për të siguruar zbatimin e tyre në praktikë.

Në vitin 2010, shihet një rritje prej 53.4% e kontributeve dhe një rritje prej afër 12.7% e numrit të kontribuesve, krahasuar me vitin 2009. Janë në proces dhe dy fonde të tjerë pensionesh vullnetare.

Tregu i pensioneve vullnetare është premtues dhe me efekte pozitive në ekonomi.

Tregu i sigurimeve mban peshën kryesore në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri.

- Në 2010 tregu i sigurimeve ka ruajtur rritje pozitive: 4% më shumë se në vitin 2009 (primet e shkruara bruto arritën në rreth 8.2 miliardë lekë), ritëm ky më i lartë, krahasuar me atë botëror, evropian apo dhe me disa vende në rajon por krahasuar me periudhat e mëparshme shënon një dinamikë më të ulët, pasojë kjo e gjithë ecurisë ekonomike financiare të vitit 2010.
- Viti 2010 vazhdoi tendencën e përmirësimit të strukturës së tregut në favor të sigurimeve vullnetare, si dhe të një dinamike të lartë të tyre.
- Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës dominoi sigurimi i zjarrit dhe rreziqeve natyrore me rreth 35%, të pasuara nga sigurimi kasko 21%, sigurimi i përgjegjësisë civile 16%.
- Primet në sigurimet e Jetës në vitin 2010 patën një rritje me rreth 18%, krahasuar me vitin 2009. Sigurimi i Jetës vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies, kryesisht për individët. Kështu 66% e rritjes ka ardhur pikërisht nga portofoli “Jetë Debitori”, ku përfitues janë bankat e nivelit të dytë, të cilat i akordojnë kredi individëve.
- Sigurimet e detyrueshme motorike vazhdojnë të dominojnë në strukturën e produkteve. (me gjithë përmirësimet në kombinim produktesh apo shërbimesh, vazhdon të mbetet problematika e shitjes nën primin e riskut apo e automjeteve të pasiguruara).

- Futja e investitorëve të huaj në treg këto vitet e fundit, ka pasur ndikimet e veta në drejtim të prezantimit të një game të re produktesh vullnetare, të cilat gradualisht po penetrojnë në treg. Përmend këtu produktet e shëndetit, të cilat megjithëse janë në fillimet e tyre, kanë perspektivë rritje, sidomos me progresin në reformën shëndetësore, ngritjen shërbimeve private shëndetësore, si dhe lehtësitë fiskale të miratuara në fund të vitit 2010 (kontributi për sigurimet shëndetësore është shpenzim i zbritshëm në të ardhurat e tatueshme).
- Pavarësisht zhvillimeve pozitive, niveli i penetrimit të sigurimeve është akoma i ulët (0.69% e PPB).
- Sektori i Sigurimeve mbetet i shëndetshëm, i kapitalizuar mirë, me investime likuide dhe pa risk e me partnerë cilësorë risiguruesish.
- Shërbimi ndaj konsumatorit me gjithë përmirësimet graduale, vlerësuar si nga ankesat e të siguruarve, rastet që shkojnë në gjykatë apo raporti dëme/prime, mbetet një objektiv i tregut, autoritetit dhe ofruesve të shërbimeve.
- Raporti dëme/prime (33% në nëntëmujorin 2010), ka një përmirësim të lehtë, por përmirësimi i cilësisë e sasisë së shërbimit mbetet sfida e tregut.

Aktiviteti Rregullues

AMF në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2009-2014, vijoi punën për nismat ligjore dhe veprimtaritë zbatuese që duhet të ndërmerren nga ana e saj. Kështu, gjatë vitit 2010, me miratimin e tre ligjeve:

- Ligjit nr. 10 158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore";
- Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe;
- Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar";

vazhdoi puna për hartimin e akteve nënligjore për një përafrim sa më të plotë të Direktivave të BE-së, për fushat specifike të mbikëqyrura nga Autoriteti dhe për një respektim të të gjitha angazhimeve, të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Janë miratuar një sërë aktesh nënligjore të mbikëqyrjes financiare jo-bankare, të hartuara apo të ndryshuara në vitin 2010:

Rregullore në fushën e pensioneve private vullnetare: "Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar", "Për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit vullnetar", "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të

investimit të fondit të pensionit”, “Për testimin e administratorëve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve”, etj.

Rregullore në fushën e letrave me vlerë “Mbi afatet, kushtet dhe procedurat për autorizim të bankave si kujdestarë të obligacioneve”, “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë”, etj.

Në fushën e sigurimeve: “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, “Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të kartonit jeshil” “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, etj.

Ligji nr. 10 236, datë 18.02.2010 “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”

Ky ligj përcakton rregullat, që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike. Ligji është në përputhje me Direktivën 2004/25/EC, datë 21 prill 2004, “Për marrjen në kontroll të shoqërive”, e cila synon të arrijë një qartësi dhe transparencë në mbarë BE-në, për çështjet që duhen zgjidhur në rast të ofertave për marrjen në kontroll të shoqërive publike dhe të parandalohet situata, në të cilën skemat e riorganizimit të shoqërive tregtare brenda BE-së të shtrembërohen nga diferencat arbitrare në kulturat e drejtimit të brendshëm të shoqërive dhe të administrimit të tyre.

Në procesin e dhënies së përgjigjeve të pyetësorit të KE-së, Autoriteti ka qenë në ndjekje të vazhdueshme të mirëmenaxhimit të këtij procesi, në përputhje me objektivin e përfundimit me sukses të tij.

Autoriteti, në vijim të Raportit Analitik të KE-së, të muajit nëntor 2010, analizoi rekomandimet e bëra në këtë raport në lidhje me Kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, si dhe ato të bëra në pjesën e “Kriterit ekonomik”. Për zbatimin e këtyre rekomandimeve, AMF ka hartuar një plan veprimi, ku përcaktohen objektivat e tij në drejtim të nismave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Në kuadrin e zbatimit të detyrimeve dhe angazhimeve që Republika e Shqipërisë ka ndaj Organizatës Botërore të Tregtisë, AMF mori pjesë në takimin e Këshillit të Tregtisë së mallrave në Gjenevë.

Aktiviteti licencues

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në ushtrimin e **funksionit licencues**, krahas funksionit mbikëqyrës, ka synuar dhe synon drejt një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar pa asimetri, si dhe rritjes së mëtejshme të besimit të publikut ndaj këtij tregu.

Risia e këtij viti, në aspektin licencues, ka qenë licencimi i shoqërisë së parë administruese të fondeve të pensionit vullnetar. Miratimi i Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, diktoi nevojën e aplikimit për licencë të instituteve ekzistuese private të pensioneve, në përshatje me kërkesat e ligjit të ri. Instituti Privat i Pensioneve Raiffeisen mori

licencën “Për fondet e pensionit vullnetar”. Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, Bordi i AMF-së, në mbledhjen e datës 18.10.2010, miratoi dhënien e licencës “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit RAIFFEISEN” sh.a për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit.

Kryerja e veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit vullnetar lidhet domosdoshmërisht me ekzistencën e depozitarit të licencuar nga Autoriteti. Autoriteti licencoi Shoqërinë “First Investment Bank - Albania” sh.a për të vepruar si depozitar, pasi vlerësoi përmbushjen e kërkesave ligjore, veçanërisht duke gjykuar mbi përshtatshmërinë e sistemit për regjistrimin e aseteve të fondit të pensioneve.

Janë konsideruar me kujdes dhe në kompleksitet produktet e reja apo të kombinuara të prezantuara në treg për të evituar të ashtuquajtura “produkte opake”, pra që ju mungon transparenca e nevojshme, si për konsumatorin ashtu edhe mbikëqyrësin.

Aktiviteti licencues në sigurime

Gjatë vitit 2010, aktiviteti licencues i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në fushën e sigurimeve u fokusua në këto drejtime:

- licencime të subjekteve që operojnë në tregun e sigurimeve si ndërmjetës: broker dhe agjentë; si dhe vlerësues të dëmeve në sigurime;
- miratime të pjesëmarrjes influencuese të kapitalit të huaj, si dhe ndryshime statutores të shoqërive të sigurimit, që lidhen me ndryshimin e kapitalit, strukturës aksionare, apo neneve të ndryshme të statutit, si dhe
- miratime të organeve drejtuese të shoqërive të sigurimit.

Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt” dhe Rregullores nr. 21, datë 26.03.2009 “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë“, 7 shoqëri u pajisën me autorizimin për të vepruar si kujdestarë të letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH-së. Operacionet e lidhura me kujdestarinë e letrave me vlerë kryhen nga bankat, të cilat paraprakisht kanë marrë miratimin nga Banka e Shqipërisë për këtë veprimtari.

Rritja e prezencës së kapitalit të huaj

Autoriteti ka krijuar hapësirat e nevojshme, në drejtim të lehtësimit të hyrjes së investitorëve dhe kapitalit të huaj në tregjet financiare jo-bankare. Vlen të përmendet se interesi në vazhdim për blerjen e aksioneve nga shoqëri të huaja financiare ka rezultuar i suksesshëm dhe kjo ka sjellë rritjen e numrit të aksionarëve të huaj që zotërojnë aksione në shoqëritë shqiptare të sigurimit. Kështu, në tregun shqiptar të sigurimeve, operojnë 10 shoqëri sigurimi, nga të cilat 4 me pjesëmarrje influencuese me kapital të huaj, njëra me pjesëmarrje 9.9% kapital i huaj aksionar.

Të nderuar deputetë,

në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, Autoriteti gjatë vitit 2010, mbështetur në kuadrin ligjor dhe në prioritetet për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes, ka analizuar dhe

monitoruar veprimtarinë e këtij tregu. Vlen të theksohet, se për pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së këtij tregu është bërë një analizë më e detajuar financiare, edhe për periudhat e ndërmjetme, mbështetur në të dhënat e raportimit tremujor të shoqërive të sigurimit për të parandaluar situata jo të përshtatshme në fund të vitit.

Rëndësi të veçantë, në çdo analizë vjetore dhe periodike, i kushtohet kërkesave për mjaftueshmëri kapitali dhe mbulimi me aktive të lejueshme të provigjoneve teknike. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të kenë mjaftueshmëri kapitali në çdo kohë. Aktualisht, shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari, sipas kërkesave të ligjit.

Gjatë analizës së gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit, për vitin 2010*, u vu re se:

Totali i aktivitetit të tregut të sigurimeve për vitin 2010* sipas pasqyrave financiare, arriti vlerën 16,6 mld lekë. Krahasuar me 31.12.2009, totali i aktivitetit u rrit me 440 mln lekë. Investimet në depozita në banka zënë pjesën më të madhe të aktivitetit me 47.7%, investimet në toka dhe ndërtesa me 9.97% të totalit të aktivitetit. Vihet re rritje kryesisht në investime, kryesisht në pasuri të paluajtshme, Bono Thesari, si dhe në zërin debitorë. Struktura e zërave të aktivitetit nuk ka pasur luhajtje të theksuara.

Gjatë vitit 2010 ka vazhduar të zbatohet sistemi i paralajmërimit të hershëm (*Treguesit Financiarë IRIS*).

Raporti i shpenzimeve, është përmirësuar gjatë vitit 2010 (me 10 pikë përqindje), ndonëse vijon të jetë mbi nivelet e përcaktuara për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në Shqipëri. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë shpenzimet operative të veprimtarisë në masën 66% për tregun e Jo-Jetës.

Inspektime në subjektet e mbikëqyrura

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit, ka ushtruar inspektime të plota dhe të planifikuara në 10 shoqëritë e sigurimit (Jetë dhe Jo-Jetë) me qëllim:

- Verifikimin në vend të aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të shoqërive të sigurimit për vitin 2009 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2010;
- Drejtimit e investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike sipas kategorive dhe limiteve të lejueshme të investimit të përcaktuar në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 dhe aktet nënligjore;
- Evidentimin e aktiveve jo të lira, të cilat nuk konsiderohen aktive në mbulim të provigjoneve teknike;
- Vlerësimin e cilësisë së aktiveve dhe nivelin e likuiditetit të tyre;
- Nivelin e përgjegjësisë të marra në sigurim nga ana e shoqërive të sigurimit dhe marrëveshjeve të risigurimit, në zbatim të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, si dhe akteve përkatëse nënligjore.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, janë kryer inspektime të përbashkëta tematike në bankat e nivelit të dytë për verifikimin e: depozitave të kompanive të sigurimit, llogarive rrjedhëse të tyre, kredive të marra nga shoqëritë e sigurimit, kontratat e sigurimit të kredive, si edhe kolaterale të garantuara prej tyre.

Në vitin 2010 janë kryer 8 inspektime tematike të planifikuara në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës lidhur me dëmet e paguara dhe të mbetura pezull për vitin 2009 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2010.

AMF, në vazhdimësi gjatë vitit 2010, ka ushtruar edhe inspektime të tjera tematike në shoqëritë e sigurimit, me qëllim verifikimin fizik të pasurive të paluajtshme të tyre, si edhe pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS), në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Masat korrigjuese dhe administrative

Gjatë vitit 2010 nga mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore dhe janë marrë masa administrative. Masat e vendosura ndaj subjekteve të mbikëqyrura kanë ndikuar në një përmirësim të qëndrueshmërisë financiare të disa subjekteve, si dhe kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut.

Masa korrigjuese, për:

- plotësimin e aftësisë paguese,
- zotërimin e aktiveve të përshtatshme në mbulim të provigjoneve teknike,
- financimin e Fondit të Kompensimit,
- plotësimin e Fondit të Garancisë së kartonit jeshil,
- ndalimin e transaksioneve me palë të lidhura,
- kufizim të depozitave bankare të bllokuara.

Mosraportim të saktë në Autoritet, për:

- Përgjegjësitë e marra,
- Pasqyrat financiare.

Paralajmërim për tërheqje licence .

Sanksion me gjobë,

Bashkëpunimi institucional

Mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit me institucionet homologe të rajonit e më gjerë, janë të domosdoshme në drejtim të përmbushjes së rolit rregullativ të AMF-së, për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jo-bankare.

AMF ka vijuar të mbajë bashkëpunim të ngushtë në mënyrë të vazhdueshme me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në përmbushje të misionit të Grupit Këshillimor të

Stabilitetit Financiar, me qëllim rritjen e efektivitetit të rregullimit të tregjeve financiare në Shqipëri.

Vlen të përmendet, në kuadër të ruajtjes së stabilitetit financiar, përgatitja e një draft Memorandumi Bashkëveprimi ndër institucional, që vendos përgjegjësitë e Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave *në raste krizash të mundshme financiare*, duke sugjeruar një mënyrë të mundshme veprimi, për një reagim të koordinuar dhe efektiv të tyre.

Bashkëpunimi me **Ministrinë e Financave**, edhe gjatë vitit 2010, ka qenë tepër i rëndësishëm dhe i suksesshëm. Në këtë aspekt, vlen të theksohet bashkëpunimi mes Autoritetit dhe Ministrisë së Financave për mënyrën e zbatimit të politikave mbi lehtësitë tatimore të sanksionuara në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, për produktet e shëndetit dhe të jetës, si dhe në drejtim të përcaktimit të roleve dhe përgjegjësi të secilës palë në procesin e emetimit të eurobondit të parë. Bashkëpunimi do vazhdojë për rishikim të sistemit tatimor në këtë fushë për të shkuar drejt standardeve dhe mbështetur tregun krahas lehtësimit të konsumatorit.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional me **Ministrinë e Transportit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor**, gjatë vitit 2010, është projektuar sistemi i integritetit të ndërsjellë të bazave të të dhënave në përkatësi. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve do të mundësojë zbatimin dhe kontrollin e legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve që lëvizin në territorin e Shqipërisë me dokumentacionin e nevojshëm ligjor, zvogëlimin e numrit të mjeteve motorike të pasiguruara apo të pa kolauduara.

Bashkëpunimi me Institucione Homologe

AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të mbikëqyrësve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. Gjithashtu AMF vijon të jetë pjesëmarrëse me kontribut aktiv, në Nënkomitetin e Bazës së të dhënave të Ligjeve të IAIS-it, i cili lidhet me shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, hartimin dhe njësimin e standardeve për t'u zbatuar më tej nga të gjithë vendet anëtare.

Mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit me institucionet homologe të rajonit e më gjerë, janë të domosdoshme në drejtim të përmbushjes së rolit rregullativ të AMF-së, për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jo-bankare. Në këtë kuadër, vlen të theksohet bashkëpunimi me **Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK)**, me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë** ku u realizua dhe nënshkrimi gjatë vitit 2010 i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, me **Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë**. etj. Gjithashtu, gjatë vitit 2010, AMF ka pasur bashkëpunim edhe me organizma të tjerë që veprojnë në fushën e tregut të sigurimeve në Austri si **Shoqata e Sigurimeve të Austrisë, VVO**.

Komunikimi me publikun dhe transparenca institucionale

Puna e pandërprerë në rritjen e cilësisë së informacionit dhe transparencës, komunikimit efektiv me publikun dhe edukimit financiar në përmbushje të rolit themelor: *Mbrojtjes së konsumatorit*, kanë qenë edhe gjatë vitit 2010 ndër prioritetet e punës së AMF-së.

Gjithashtu, në fokus të punës sonë edukative kanë vazhduar të jenë edhe gazetarët dhe mediat, si aktorë të rëndësishëm në ndërmjetësimin e dialogut mes Autoritetit dhe publikut. AMF ka pasur një prezencë aktive në median e shkruar dhe elektronike, si një instrument për të komunikuar zhvillime të rëndësishme në tregjet financiare jo-bankare apo dhe për të qenë palë në dialogun mes grupeve të interesit për zhvillimin e këtyre tregjeve. Media e shkruar dhe elektronike ka shërbyer gjithashtu për të përcjellë mesazhin e AMF-së publikut, në funksion të fushatave sensibilizuese në drejtim të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit.

Shërbimi i konsumatorit

Gjatë vitit 2010, ky shërbim nëpërmjet linjës telefonike, ka pasur një rritje të ndjeshme të telefonatave. Sistemi ka trajtuar mbi 600 telefonata në mënyrë automatike dhe mbi 100 çështje nëpërmjet interagimit me specialistët e Drejtorisë së Zbatueshmërisë dhe sektorëve të tjerë të Autoritetit.

Në kuadër të edukimit financiar të publikut, gjatë vitit 2010, botimet tona janë shtuar në numër dhe larmishmëri, duke i shërbyer më mirë grupeve të ndryshme të interesit. Së fundi, në drejtim të rritjes së cilësisë së informacionit dhe përmirësimit të statistikave, u hartua dhe publikua, botimi *Sigurime – 10 Vjet Statistika*.

Faqja e internetit e Autoritetit, ofron tashmë një portal eficient të dhënies të informacionit, të organizuar dhe përshtatur për gruppëdorues të ndryshëm.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të paraqes përpara jush në mënyrë të përmbledhur edhe disa çështje që kanë të bëjnë **me forcimin e kapaciteteve institucionale të AMF-së.**

AMF, i ka kushtuar vëmendje dhe energji të veçantë rritjes së kapaciteteve institucionale, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, modernizimit të infrastrukturës teknike kërkuese, etj.

Një ndër zbatimet e mëdha për vitin 2010, shënoi përfundimi i rikonstruksionit të mjediseve të reja të AMF-së, duke krijuar për stafin kushte bashkëkohore dhe infrastrukturë moderne në mjedisin profesional dhe social të punës.

Struktura e Autoritetit miratohet nga i Kuvendi i Shqipërisë me propozimin e Bordit të AMF-së. Edhe gjatë vitit 2010, Autoriteti vazhdoi të funksionojë sipas strukturës dhe organikës së miratuar në bazë të Vendimit të Kuvendit nr. 98, datë 30.04. 2007 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

AMF, edhe vitin 2010, u financua vetëm me fonde tërësisht të krijuara nga të ardhurat e saj.

Në funksion të kësaj politike, AMF për shkak të disa kufizimeve ligjore, nuk arrin të përdorë maksimalisht mjetet dhe politikat stimuluuese për tërheqjen dhe mbajtjen e kapaciteteve profesionale edhe pse statusi që institucioni ynë ka, burimet specifike të financimit, krijojnë mundësi për nxitje më të madhe të punonjësve që aplikojnë ekspertizë të lartë teknike në punë.

Zhvillimet e fundit të teknologjisë e informacionit, në mbështetje të objektivave ambicioze të zhvillimit të tregut dhe përafrimit të mbikëqyrjes me standardet ndërkombëtare, si dhe vendosja në godinë më vete e institucionit, kërkon përshtatjen e disa elementëve të strukturës, për të cilat shpresojmë që të gjejmë mirëkuptimin dhe mbështetjen e komisionit të ekonomisë dhe financave në Kuvend .

Të nderuar deputetë,

Përafrimi i legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, strukturimi i zhvillimit të tregjeve sipas standardeve dhe mbrojtja e konsumatorit, mbeten objektivat kryesorë, që përbëjnë dhe fokusin e punës së AMF-së në të ardhmen.

Fokusi dhe energjitë e një pune tre vjeçare, priten të finalizohen në vitin 2011, duke bërë të mundur futjen gradualisht të metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë risku, si një mbikëqyrje efektive në sigurime.

Fokusi i Autoritetit për vitin 2011, vazhdon të mbetet dhe forcimi i kapaciteteve institucionale. Kjo ka sjellë dhe nevojën për ndryshime në Ligjin "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", për të siguruar të gjitha elementet e nevojshme të pavarësisë, për ushtrimin e aktivitetit të një institucioni mbikëqyrës financiar, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe motivimin e personelit të kualifikuar në këtë fushë.

Nismat dhe ndryshimet ligjore të viteve të fundit, në të tre tregjet nën juridiksionin e AMF-së, përbëjnë hapa cilësorë në drejtim të përafrimit të standardeve rregullative me ato të Bashkimit Evropian, hapësirave për zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve financiare jo-bankare, si dhe në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Tendencat globale të largimit nga mbikëqyrja tradicionale drejt asaj me bazë risku, janë përkrahur nga AMF dhe janë përkthyer në një punë intensive me mbështetjen e Bankës Botërore, për të kaluar në një mbikëqyrje më efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri, në fokus të së cilës do të jetë risku dhe për rrjedhojë përdorimi më efikas i burimeve të kufizuara.

Të gjithë këto zhvillime cilësore, i hapin rrugën sfidave përherë e më të mëdha, që karakterizojnë një treg dinamik e në zhvillim si Shqipëria, sfida të cilat përballohen me strategji të qarta, staf të kualifikuar dhe komunikim proaktiv me aktorët e tregut.

Veprimtaria e përshkruar në këtë raport ka qenë një sfidë dhe një ngarkesë për të gjithë stafin e AMF-së që e ka përballuar me përkushtim dhe entuziazëm. Gjithashtu, anëtarët e Bordit, si bashkëpunëtorë me vizion kanë kontribuar me rolin e tyre profesional dhe të përgjegjshëm, për ngritjen e një institucioni eficient dhe modern.

Shpreh mirënjohjen për mbështetjen tuaj, si dhe për gjithë ato që e asistuan AMF-në.

Ju faleminderit për vëmendjen,

Elisabeta Gjoni